

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Komisioni Evropian paralajmëron rishikimin e negociatave me Serbinë, pas glorifikimit të Mlladiçit
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/komisioni-evropian-paralajmëron-rishikimin-e-negociatave-me-serbine--i473609
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:24:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 17:38:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ec5fa9d2afa3f9e62aabe456e3097901cb77f40f95d0de22ac4ada55bf263fd1
TEKSTI	8e84cf016854a34d24cb8ff3fd684bce27f35366eda817f459abc9d1bba11ed6
PAMJA	540b6c475ecde83cc62ed7c33c5d908c51efe3a314149aef732f6cde34cf629a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	112090d06f258ce811da20d9fdb8e96208bd3373071e6e8264867f377e16323c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/112090d06f258ce811da20d9fdb8e96208bd3373071e6e8264867f377e16323c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

21:06 Aktualitet

Plarent Ndreca ka zbuluar se ekziston një pushtet tjetër p...

Komisioni Evropian paralajmëron rishikimin e negociatave me Serbinë, pas glorifikimit të Mlladiçit



8 Shtator 2026, 19:38, Kosova & Bota CNA



Komisioni Evropian e ka paralajmëruar Serbinë se mundësia e vazhdimin të bisedimeve për pranimin e saj në Bashkimin Evropian do të shqyrtohet, pasi vendi nga Ballkani e varrosi me nderime shtetërore dhe ushtarake Ratko Mlladiq, të dënuarin për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

"Siç e dini, diskutimet mbi Grupin 3 janë duke u zhvilluar aktualisht me shtetet anëtare. Dhe, për këtë diskutim duhet të merren parasysh zhvillimet e fundit politike që i kemi parë", tha Guillaume Mercier, zëdhënësi i Komisionit Evropian për zgjerimin, në një konferencë për shtyp të martën.

Për vite me radhë, Komisioni Evropian ka mbështetur vazhdimin e bisedimeve për pranimit midis Bashkimit Evropian dhe Serbisë, duke rekomanduar hapjen e Grupit 3, për të cilin Serbia konsiderohet teknikisht e gatshme.

Angazhimi i tundit intensiv mbi kete çështje ishte para pushimeve verore, kur Komisioni Evropian u beri thirrje shteteve anetare te arrinin nje marreveshje per hapjen e ketij grupi dhe kështu të zhbllokoni procesin e negociatave, i cili praktikisht kishte ngecur në pothuajse pesë vjetët e fundit.

"Në korrik, ne bëmë vlerësimin tonë në lidhje me Grupin 3. Ishte një vlerësim teknik i reformave dhe hapave të ndryshëm që duheshin përfunduar në mënyrë që Grupi 3 të ishte i hapur. Ky vlerësim u bë në korrik, bazuar në të gjithë elementët përkatës që ishin në dispozicion në atë kohë", shpjegoi Mercier.

Serbia nuk ka hapur asnjë kapitull të ri negociatash që nga dhjetori i vitit 2021.

Fillimisht, arsyeja për këtë ishte mungesa e përputhshmërisë me politikën e jashtme të BE-së, kryesisht dështimi për të vendosur sanksione ndaj Rusisë në përgjigje të agresionit kundër Ukrainës, ndërsa më vonë gjendja e sundimit të ligjit nxiti më tej skepticizmin e disa shteteve anëtare.

Gjendja është ndërlukuar edhe më shumë tani pas ngjarjeve lidhur me vdekjen dhe varrosjen e Mlladiqit.

Mlladiq vdiq më 27 gusht në Hagë, ku po vuante dënimin, në moshën 85 vjeç, dhe u varros në Beograd të hënën me nderime shtetërore e ushtarake, duke ngjallur reagime të ashpra nga bashkësia ndërkombëtare.

Tribunali i Hagës e dënoi Mlladiqin me burgim të përjetshëm për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, në qershor 2021.

Ai u shpall fajtor për gjenocidin e kryer kundër rreth 8.000 boshnjakëve në Srebrenicë, një zonë e mbrojtur nga OKB-ja, në verën e vitit 1995.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, lëshuan një deklaratë të përbashkët, duke i përshkruar skenat nga Beogradi gjatë varrimit të kriminelit të dënuar të luftës, Mlladiq, si "tronditëse".

"Elementet e mbështetjes zyrtare, si dhe prania e disa zyrtarëve të lartë serbë në varrim, janë thellësisht dëshpëruese. Ato tregojnë dështimin për t'u përballur me kapitullin e errët të historisë së vonshme evropiane, dhe janë në kundërshtim me vlerat mbi të cilat bazohet rruga e Serbisë drejt Bashkimit Evropian", theksuan në një deklaratë të përbashkët liderët e institucioneve kryesore evropiane.

Ndërkohë, von der Leyen së shpejti do të nisë turneun e saj të rregullt vjetor në vendet e rajonit. Ende nuk ka konfirmim nëse ajo do të vizitojë Serbinë me atë rast./REL

22:55 | 25 shtator



BLOG**MITET E IQ-SË DHE GJENITË E VËRTETË**

Pse rezultatet e larta nuk mjaftojnë

GRUPET KRIMINALE NË VEND

19:16 ▼

Berisha: U deklaroj organizatave kriminale të Elbasanit, Durrësit, Shkodrës e Shqipërisë, vend mbi tokë nuk do të keni veç burgut

kuriozitet

Për prof. Al-Khalil jeta e pafundme do të zbehë peshën e dashurisë, krijimtarisë, udhëtimeve e kohës me njerëzit e afërt

INSTAGRAM

@CNALAJME





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Bosnja dëbon dy diplomatë serbë për shkak të lartësimit të Mlladiçit

Kanadaja përgatitet për një luftë të zgjatur tregtare, ndërsa hyjnë në fuqi kundër-tarifat ndaj SHBA-së

Senatori amerikan plas “bombën”: Ndaloni zhvillimin e Inteligjencës Artificiale për të shmangur një katastrofë

Varrimi i Ratko Mlladiç/ Kurti: Serbia kaloi nga mohimi në adhurimin shtetëror të gjenocidit

Dënohet me një vit burg me kusht ministri në Kosovë

Rusia i jep fund armëpushimit/ Një seri shpërthimesh trondit Kievin

Përkallëzohet lufta tregtare SHBA-Kanada/ Trump kërcënon të bllokojë avionët Bombardier nga tregu amerikan

Rusia mbyll Konsullatën Gjermane në Shën Petersburg

Trump në telefonatë me kryeministrin britanik Burham, fokus te lufta Ukrainë-Rusi

Kina me skenarë të rinj për luftrat/ Betejë me humanoidë, qen robotë dhe mjete pa pilot

Vrau motrën dhe plagosi nënën / Vihet në pranga 1 person

Nxehtësia ekstreme dëmton vreshtat në Francë/ Përgjysmohet prodhimi i shampanjës

Rusia dhe Koreja e Veriut hapin urën e parë rrugore përgjatë kufirit të tyre të përbashkët

Mbreti e bën të qartë/ Harry dhe Meghan mbeten anëtarë joaktivë të familjes mbretërore

Kryeministri i Serbisë kërkesë presidentit të shpërndajë Parlamentin

Pas varrimit të Mlladiçit me nderime shtetërore/ Sarajeva tërheq stafin e ambasadës në Serbi

Tragjedi nga rënia e orteikut në Rusi/ 11 alpinistë humbin jetën, 6 të tjerë të plagosur

Sulmet izraelite vrasin 12 persona në një fshat në jug të Libanit

Triumfi i AfD-së në Saksoni-Anhalt/ Merz: Disfata më e keqe e CDU-së në dekada

Paralajmërimi i OKB-së: Inteligjenca artificiale mund të paraqesë rrezik ekzistencial për njerëzimin

[editorial](#)

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM

22:55 | 25 shtator



BLOG
MITET E IQ-SË DHE GJENITË E VËRTETË
Pse rezultatet e larta nuk mjaftojnë



GRUPET KRIMINALE NË VEND
19:16 ▾
Berisha: U deklaroj organizatave kriminale të Elbasanit, Durrësit, Shkodrës e Shqipërisë, vend mbi tokë nuk do të keni veç burgut

kuriozitet
Dër prof. Al-Khalil ieta e nafundme do të zbehë neshën e dashurisë

INSTAGRAM

Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.